



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05
Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore Dr. Fidelma Donlon

Data: 27 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të Akuzuarit
Julius von Bóné

Zyrës Administrative
Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	3
III.	DISKUTIM	4
A.	Parimet e procesit të parashtrimit të kërkesave prej viktimave	4
B.	Informacioni që u jepet parashtruesve të mundshëm të kërkesave	6
C.	Mbledhja e kërkesave	6
D.	parashtrimi i kërkesave	7
E.	Vlerësimi i kërkesave	11
1.	Pranueshmëria e kërkesave	11
(a)	Standardi i vërtetimit: provat <i>prima facie</i>	11
(b)	Person fizik	12
(c)	Krimi (krimet) e pretenduara	13
(d)	Dëmi i pësuar personalisht	13
(e)	Rezultati i drejtpërdrejtë i një krimi që përmban Aktakuza	15
(f)	Rekomandimi i ZPV-së	16
2.	Grupimi i parashtruesve të kërkuesve	16
3.	Masat mbrojtëse	18
F.	Roli i palëve në procesin e parashtrimit të kërkesave	19
G.	Mjetet ligjore për kërkesat e refuzuara	21
IV.	VENDIM	21

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 22(1), 34(6), 39(1) dhe (13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 23(5), 95(2)(i) dhe 113 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), jep këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës”, (“Vendim i Konfirmimit”),² bashkë me, ndër të tjera, fletarrestimin dhe urdhrin e transferimit për Salih Mustafën (“z. Mustafa” ose “i akuzuari”).³
2. Më 19 qershor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.⁴
3. Më 24 shtator 2020, z. Mustafa u arrestua⁵ dhe u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë.⁶

¹ KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetari, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Një version publik i redaktuar u dorëzua më 5 tetor 2020.

³ KSC-BC-2020-05, F00009/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Salih Mustafa*, 12 qershor 2020, tepër konfidencial dhe *ex parte*; F00009/A02, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versionet publike të redaktuara të të dy dokumenteve u dorëzuan më 24 shtator 2020.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00011/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, konfidenciale. Një version publik i redaktuar i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 28 shtator 2020 (KSC-BC-2020-05, F00019/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Versionit të Redaktuar më tej të Aktakuzës së Konfirmuar*, 28 shtator 2020, publik).

⁵ KSC-BC-2020-05, F00013, Administratorja, *Njoftimi i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 24 shtator 2020, publik.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00014, Administratorja, *Njoftimi i Pranimit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

4. Më 28 shtator 2020, z. Mustafa bëri paraqitjen e tij të parë.⁷ Më 28 tetor 2020, ai u vetëdeklarua i pafajshëm.⁸

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Sipas nenit 22(1) të Ligjit dhe rregullës 2 të Rregullores, viktimë është një person fizik që ka pësuar dëmtim, përfshirë dëmtim fizik, mendor apo material, si pasojë e një krimi brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe të paraqitur në një aktakuzë të konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

6. Sipas rregullës 113(1) të Rregullores, pas konfirmimit të një aktakuze dhe në një kohë të mjaftueshme përpara hapjes së çështjes, një person që pretendon se është viktimë e një krimi të pretenduar në aktakuzë mund të bëjë një kërkesë për praninë si viktimë pjesëmarrëse në proces ("VPP"), në të cilën saktëson se si i plotëson kushtet për të qenë viktimë dhe jep vendin dhe datën e kryerjes së veprës penale që pretendohet se ka shkaktuar dëm.

7. Sipas nenit 34(6) të Ligjit dhe rregullës 23(5) të Rregullores, Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave ("ZPV") administron, ndër të tjera, sistemin e pjesëmarrjes së viktimave të parashikuar në nenin 22 të Ligjit dhe Rregullores. ZPV-ja ofron ndihmë dhe këshillime për viktimat pjesëmarrëse në procese.

8. Sipas rregullës 113(2) të Rregullores, ZPV-ja regjistron dhe vlerëson kërkesat dhe ia paraqit Gjykatësit të Procedurës Paraprake bashkë me një rekomandim për pranueshmëri dhe përfaqësim të përbashkët dhe një kërkesë për masa mbrojtëse në bazë të rregullës 80 të Rregullores, sipas rastit.

9. Në përputhje me rregullën 113(1)-(3) të Rregullores, palët nuk kanë qasje në formularët e kërkesës dhe marrin vetëm një raport konfidencial të paraqitur nga ZPV-

⁷ KSC-BC-2020-05, Transkripti, 28 shtator 2020, publik, f. 11, rreshtat 24-25.

⁸ KSC-BC-2020-05, Transkripti, 28 tetor 2020, publik, f. 60, rreshtat 2-17.

ja në bazë të të cilit ato mund të bëjnë parashtrimet e tyre lidhur me aspektin ligjor të pranueshmërisë dhe përfaqësimit të përbashkët.

10. Në përputhje me rregullën 113(4)-(5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton nëse paraqitësi i kërkesës ka dhënë prova *prima facie* për dëmin e pësuar si rezultat i drejtpërdrejt i një veprë penale të përfshirë në aktakuzë dhe nxjerr një vendim të arsyetuar me anë të të cilit miraton ose refuzon kërkesën. Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr vendim për përfaqësimin e përbashkët në proces, si dhe për çfarëdo kërkesë për masa mbrojtëse. Vendimi u njoftohet paraqitësit të kërkesës, Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave dhe palëve.

11. Në përputhje me nenin 22(4) të Ligjit, viktimat pjesëmarrëse në proces krijojnë një grup, përveçse kur Paneli urdhëron që viktimat të ndahen në më shumë se një grup. Sipas rregullës 113(8) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në konsultim me ZPV-në, vendos nëse duhet t'i ndajë viktimat pjesëmarrëse në proces në grupe me përfaqësim të përbashkët, duke marrë parasysh nëse kanë interesa të kundërta që mund të pengojnë përfaqësimin e përbashkët, interesa të ngjashme që mund të lehtësojnë përfaqësimin e përbashkët, si dhe të drejtat e të akuzuarve dhe interesat e gjykimit të drejtë dhe të shpejtë.

12. Sipas rregullës 113(6) të Rregullores, parashtruesve të kërkesave të cilëve u refuzohet kërkesa kanë të drejtën e apelimit të vendimit brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh. Një palë mund të kërkojë leje për apelimin e vendimit, por vetëm mbi bazën e gabimeve ligjore.

III. DISKUTIM

A. PARIMET E PROCESIT TË PARASHTRIMIT TË KËRKESAVE PREJ VIKTIMAVE

13. Korniza ligjore e Dhomave të Specializuara mundëson disa hapa proceduralë që duhen ndërmarrë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, palët dhe mbrojtësi i

viktimave, sipas rastit, nga paraqitja fillestare e të akuzuarve dhe kalimi i dosjes së çështjes tek Trupi Gjykses, në përputhje me rregullën 98 të Rregullores. Një prej këtyre hapave ka të bëjë me vendimet lidhur me kërkesat për t'u pranuar si viktimë pjesëmarrëse në proces, sikurse përcaktohet në rregullën 95(2)(i) të Rregullores.

14. ZPV-ja luan një rol qendror në procesin e paraqitjes së kërkesave prej viktimave, ndër të tjera, përmes mbledhjes së kërkesave dhe duke ia paraqitur ato Gjykatësit të Procedurës Paraprake, duke bërë rekomandime për pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, si edhe duke kërkuar masa mbrojtëse për parashtruesit e kërkesave. Njësi të tjera të Zyrës së Administratës gjithashtu mund të përfshihen në aspekte të ndryshme të procesit të parashtrimit të kërkesave. Gjithashtu, ZPS-ja duhet t'i bëjë të ditur ZPV-së se kush prej tyre ka pësuar dëm si pasojë e një krimi të pretenduar në Aktakuzën e Konfirmuar. Për të siguruar efikasitetin dhe shpejtësinë e procesit të paraqitjes së kërkesave dhe për të ndihmuar ZPV-në dhe të gjithë palët e tjera të interesuara të përfshira në këtë proces, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të nevojshme të japë orientim në kohë dhe të hollësishëm, me udhëzime të qarta, të thjeshtëzuara për zbatimin e dispozitave përkatëse.⁹

15. Gjithashtu, për t'i mundësuar ZPV-së kryerjen e funksioneve të saj, të përcaktuara në nenin 34(6) të Ligjit dhe rregullën 113(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjen me vend t'i ofrojë ZPV-së qasje në versionet e paredaktuara të Aktakuzës së Konfirmuar dhe Vendimit të Konfirmimit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kujton ZPV-së klasifikimin rreptësisht konfidencial të parashtrimeve të mësipërme dhe e udhëzon të mos nxjerrë për askënd asnjë informacion që është objekt i redaktimeve që përmbajnë versionet publike përkatëse.

⁹ *Po aty, ICC, Prosecutor v. Ntaganda, Pre-Trial Chamber II, Decision Establishing Principles on the Victims' Application Process ("Ntaganda Principles Application Process"), ICC-01/04-02/06-67, 28 May 2013, para. 3; Prosecutor v. Ongwen, Pre-trial Chamber II, Decision Establishing the Principles Applicable to Victims' Application Process ("Ongwen Principles Application Process"), ICC-02/04-01/15-205, 4 March 2015, para. 1-2.*

B. INFORMACIONI QË U JEPET PARASHTRUESVE TË MUNDSHËM TË KËRKESAVE

16. Është kyç që të ndërmerren veprime efikase dhe me kohë për ndërgjegjësim dhe komunikim, për të informuar parashtruesit e mundshëm të kërkesave mbi mandatin e DHS-së dhe sistemin e pjesëmarrjes së viktimave.¹⁰ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake këshillon që, kurdoherë që është e realizueshme, ZPV-ja duhet t'u ofrojë parashtruesve të mundshëm të kërkesave informacion të plotë, të saktë, të thukët dhe të disponueshëm, ndër të tjera në lidhje me: (i) mandatin e DHS-së; (ii) parametrat materialë, kohorë dhe gjeografikë të veprave penale të konfirmuara në aktakuzën e DHS-së, për aq sa lejohet nga redaktimet e zbatuara; (iii) hapat e procesit të paraqitjes së kërkesës; (iv) veçoritë kryesore të sistemit të pjesëmarrjes së viktimave; dhe (v) sistemin e zhdëmtimit të DHS-së.¹¹

C. MBLEDHJA E KËRKESAVE

17. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, kurdoherë që është e realizueshme, ZPV-ja duhet t'i ndihmojë parashtruesit e kërkesave në plotësimin e formularit katërfaqësh të "Kërkesës për Pranim si Viktimë Pjesëmarrëse në Proces", që mund të gjendet në faqen e internetit të DHS-së ("Formulari i Kërkesës"). Një ndihmë e tillë, qoftë e drejtpërdrejt apo nga larg, sipas rastit, duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të përmbajtjes së Formularit të Kërkesës dhe të procesit të parashtrimit të kërkesës dhe, për aq sa është e nevojshme, udhëzim për plotësimin e pjesëve të

¹⁰ *Po aty*, ICC, *Ntaganda Principles Application Process*, para. 12; *Ongwen Principles Application Process*, para. 10.

¹¹ *Po aty*, ICC, *Ntaganda Principles Application Process*, para. 13; *Ongwen Principles Application Process*, para. 12; *Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, Pre-Trial Chamber II, *Decision Establishing the Principles Applicable to Victims' Application for Participation* ("*Yekatom and Ngaïssona Principles Application Process*"), ICC-01/14-01/18-141, 5 March 2019, para. 12.

veçanta të Formularit të Kërkesës.¹² Megjithatë, viktimat janë gjithashtu të lira ta mbushin Formularin e Kërkesës vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi.

18. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake udhëzon ZPV-në të raportojë mbi mënyrën se si janë marrë kërkesat, numrin e kërkesave dhe periudhën gjatë së cilës janë marrë këto kërkesa, sikurse përcaktohet në paragrafin 24.

D. PARASHTRIMI I KËRKESAVE

19. Kërkesat mund t'i parashtrohen Gjykatësit të Procedurës Paraprake deri në paraqitjen e parashtrimit të Mbrojtjes sipas rregullës 95(5) të Rregullores, që është afati i fundit për kërkesat e paraqitura gjatë fazës së procedurës paraprake. Pas kësaj date, ZPV-ja mund t'i parashtrojë kërkesa Trupit Gjykues, në pajtim me vendimet e atij Trupi Gjykues.

20. Sipas rregullës 113(2) të Rregullores, ZPV-ja duhet t'i regjistrojë dhe vlerësojë kërkesat e marra para se t'ia dorëzojë Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Kjo realizohet përmes një procesi në të cilin ZPV-ja (i) i regjistron kërkesat e marra dhe i cakton një pseudonim çdo parashtruesi kërkesë; (ii) shqyrton përmbajtjen e kërkesave të marra për të identifikuar informacionin që mungon ose që është i paplotë dhe/ose i pasaktë; (iii) nëse është e nevojshme, u drejtohet parashtruesve të kërkesave duke kërkuar informacion ose material shtesë për plotësimin e kërkesave; dhe (iv) i përgatit kërkesat për dorëzim, siç përcaktohet më poshtë.

21. Lidhur me pseudonimet, Gjykatësi i Procedurës Paraprake udhëzon ZPV-në që të caktojë nga një numër për çdo parashtrues kërkesë, pavarësisht nëse parashtruesi i kërkesës ka kërkuar ose nuk ka kërkuar masa mbrojtëse. Pseudonimi i caktuar në këtë mënyrë duhet të përdoret si i vetmi identifikues i viktimës në parashtrimet e

¹² *Po aty*, GJPN, *Ntaganda, Principles Application Process*, para. 26; *Ongwen, Principles Application Process*, para. 23.

protokolluara publike dhe (rreptësisht) konfidenciale, përveç nëse paneli kompetent urdhëron ndryshe.

22. Që një kërkesë të konsiderohet e plotë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se duhet të përmbushen së paku kriteret në vijim: (i) të ketë prova të mjaftueshme për identitetin dhe, nëse është e rëndësishme, lidhjen familjare dhe/ose kujdestarinë ligjore; (ii) të dhënat personale të jenë të plota; (iii) të jenë plotësuar të gjitha pjesët e formularit të kërkesës; (iv) të jenë shënuar mjaftueshmërisht qartë data/periudha dhe vendndodhja e krimeve, si dhe dëmi i pësuar; (v) të jetë paraqitur dokumentacioni i rëndësishëm dhe i mjaftueshëm për atë që ka qenë e mundshme; dhe (vi) kërkesa të jetë nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës ose kujdestar ligjor i tij/saj.

23. ZPV-ja duhet të përpiqet që t'i paraqesë Gjykatësit të Procedurës Paraprake vetëm kërkesa të plota. Për këtë qëllim, ZPV-ja duhet t'i kontrollojë kërkesat shpejt dhe, nëse është e nevojshme, t'i kontaktojë parashtruesit e kërkesave për të kërkuar informacion ose material shtesë për plotësimin e kërkesave. Nëse, me gjithë përpjekjet maksimale të ZPV-së, kërkesa nuk mund të plotësohet, gjithsesi, ZPV-ja duhet t'ia dorëzojë kërkesën Gjykatësit të Procedurës Paraprake, duke vënë në dukje masat që janë marrë për plotësimin e kërkesës dhe arsyet e mosplotësimit. Në fund të fundit, të gjitha kërkesat, të plota ose të paplota, duhet t'i dorëzohen Gjykatësit të Procedurës Paraprake, përveçse kur tërhiqen nga parashtruesit e kërkesave.

24. Sa i përket përgatitjes për paraqitje të kërkesave të parashtruesve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në përputhje me rregullën 113(2) të Rregullores, ZPV-ja duhet të paraqesë parashtrim përmbledhës ("Raport për GJPP-në") që konkretisht përfshin si më poshtë:

(a) një raport që përmban:

- (i) mënyrën në të cilën janë marrë kërkesat, numrin e kërkesave të marra dhe periudhën në të cilën janë marrë këto kërkesa;

- (ii) veprimet kryesore të ndërmarra nga ZPV-ja për të përcaktuar plotësinë e kërkesave;
 - (iii) numrin, sipas rastit, të: (i) kërkesave të plota të paraqitura dhe (ii) kërkesave të paplota të paraqitura dhe një përmbledhje të arsyeve pse ZPV-ja ka vendosur që megjithatë t'i paraqesë. Në Raportin e vet të fundit për GjPP-në, para afatit të fundit të përmendur në paragrafin 19, ZPV-ja duhet gjithashtu të bëjë të ditur numrin e të gjitha kërkesave të paplota që nuk janë paraqitur dhe nëse ZPV-ja parashikon veprime të mëtejshme për të siguruar plotësinë e tyre;
- (b) një përmbledhje të rekomandimeve për pranueshmërinë e kërkesave, duke marrë parasysh kriteret e përmendura në paragrafët 27-39;
- (c) një përmbledhje të rekomandimeve lidhur me grupimin e viktimave për përfaqësim të përbashkët, duke marrë parasysh kriteret e përmendura në paragrafët 41-43;
- (d) një përmbledhje të masave mbrojtëse të kërkuara, duke marrë parasysh kriteret e përmendura në paragrafët 44-47;
- (e) shtojcat si në vijim:
- a. një shtojcë me tabela konfidenciale dhe *ex parte* që përmbajnë, sipas rastit, numrin dhe të dhënat e parashtruesve të kërkesave që rekomandohen për pranim – Grupi A, nuk rekomandohen për pranim – Grupi B, ose në lidhje me të cilët ZPV-ja nuk jep rekomandim – Grupi C;
 - b. shtojcat konfidenciale dhe *ex parte*, për çdo kërkesë të paraqitur, që përmbajnë një “Përmbledhje të Kërkesës” të thukët të përgatitur nga ZPV-ja, bashkë me Formularin e Kërkesës përkatëse dhe materialin

mbështetës.¹³ “Përmbledhja e Kërkesës” duhet të përmbajë informacionin vijues, duke marrë parasysh kriteret e përmendura në paragrafët 27-47:

- (i) pseudonimin që i është caktuar parashtruesit të kërkesës;
- (ii) të dhënat personale të parashtruesit të kërkesës, duke përfshirë mbiemrin, emrin, datën dhe vendin e lindjes, shtetësinë, gjuhët që flet, dhe nëse parashtruesi i kërkesës është viktimë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë;
- (iii) një përshkrim të hollësishëm por të thukët të ngjarjes (ngjarjeve), duke përfshirë parametrat gjeografikë dhe kohorë, që kanë të bëjnë me krimin (krimet) në aktakuzën e konfirmuar, dhe kryesin (kryesit) ose grupin (grupet) që mbahen përgjegjës, nëse dihen;
- (iv) dëmet e pësuar, përfshirë një përmbledhje të dokumentacionit të paraqitur për të dëshmuar dëmin e pësuar, për aq sa është i disponueshëm, dhe shkakësisë midis ngjarjes (ngjarjeve) dhe dëmit të pësuar;
- (v) rekomandimin e ZPV-së lidhur me pranueshmërinë;
- (vi) kur është me rëndësi, kërkesën e parashtruesit për masa mbrojtëse dhe vlerësimin dhe rekomandimin e ZPV-së në këtë aspekt; dhe
- (vii) rekomandimin e ZPV-së në lidhje me grupimet, duke treguar origjinën, gjuhën, vendndodhjen gjeografike dhe konfliktet e mundshme të interesit të parashtruesit të kërkesës dhe preferencat/opinionet e deklaruara nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me përfaqësimin juridik.

¹³ Formularët e Kërkesës sipas Grupit A dhe C duhen dorëzuar me një përkthim të rishikuar. Formularët e Kërkesave sipas Grupit B duhen dorëzuar me një përkthim të parashikuar. Nuk është i nevojshëm përkthimi i materialit mbështetës .

25. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu gjykon se ZPV-ja duhet t'i paraqesë periodikisht raporte të tilla GPP-së, në përputhje me afatet e përcaktuara në paragrafin 55.

E. VLERËSIMI I KËRKESAVE

26. ZPV-ja udhëzohet që të kryejë vlerësimin paraprak në lidhje me pranueshmërinë e kërkesave, grupimin e parashtruesve të kërkesave dhe masat mbrojtëse të kërkuara.

1. Pranueshmëria e kërkesave

27. Në përputhje me nenin 22(1) të Ligjit dhe rregullat 2, 113(1) dhe (4) të Rregullores, viktima që është parashtrues i kërkesës pranohet të marrë pjesë në proces, në qoftë se ka prova *prima facie* se:

- (a) parashtruesi i kërkesës është person fizik;
- (b) parashtruesi i kërkesës ka përshkruar në kërkesë vepra që duket se përbëjnë krim brenda kuadrit të Aktakuzës së Konfirmuar;
- (c) parashtruesi i kërkesës ka pësuar dëm personalisht; dhe
- (d) dëmi ka qenë rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të përfshirë në Aktakuzën e Konfirmuar.

- (a) Standardi i vërtetimit: provat *prima facie*.

28. Sipas rregullës 113(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson informacionin dhe materialin mbështetës të paraqitur mbi bazë *prima facie*.¹⁴ Për këtë

¹⁴ Termi *prima facie* do të thotë “në vështrim të parë; me sa duket; siç duket në fillim pa bërë hetime”. *Shih*, OED Online. Oxford University Press, shtator 2020. Web. 26 November 2020, <https://www.oed.com/view/Entry/151264?redirectedFrom=prima+facie#eid>

arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton informacionin dhe materialin mbështetës të paraqitur rast pas rasti,¹⁵ duke marrë parasysh: (i) të gjitha rrethanat përkatëse sikurse duken në pamje të parë;¹⁶ dhe (ii) lidhjen e brendshme logjike të kërkesës.¹⁷

(b) Person fizik

29. Sipas nenit 22(1) të Ligjit dhe rregullës 2 të Rregullores, vetëm personat fizikë lejohen të marrin pjesë si VPP në proceset e DHS-së. Rrjedhimisht, personat juridikë janë të përjashtuar nga pjesëmarrja. Për të paraqitur kërkesë të vlefshme, personi fizik duhet të ketë aftësi juridike.¹⁸ Sikurse tregohet në Formularin e Kërkesës, parashtruesi i kërkesës që është nën moshën 18 vjeç ose që është shpallur juridikisht i paaftë, duhet të përfaqësohet nga prindi ose kujdestari ligjor.¹⁹

30. Parashtruesit e kërkesave mund të paraqesin si dëshmi të identitetit: (i) dokumente identifikimi shtetërore, si letërnjoftim, pasaportë, leje qëndrimi, patentë e shoferit; dhe (ii) kur dokumentet e identifikimit nuk janë të disponueshme, çfarëdo dokumenti tjetër të besueshëm që përmban informacion që e identifikon parashtruesin e kërkesës, si certifikatë mjekësore, dokumente identifikuese nga vendi i punës, dokumentacion i lëshuar nga autoritetet lokale. Kur parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga prindi ose kujdestari ligjor, si dëshmi e kujdestarisë ligjore mund të

¹⁵ *Po aty*, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, Pre-Trial Chamber, *Decision on Victims' Participation in the Proceedings* ("Ayyash et al. Decision on Victim Participation"), 8 May 2012, para. 62.

¹⁶ *Po aty*, ICC, *Prosecutor v. Gbagbo*, Pre-Trial Chamber I, *Vendimi on Victim's Participation and Victims' Common Legal Representation at the Confirmation of Charges Hearing and in the Related Proceedings*, ICC-02/11-01/11-138, 4 June 2012, para. 21.

¹⁷ *Po aty*, ICC, *Prosecutor v. Bemba*, Pre-Trial Chamber III, *Fourth Decision on Victims' Participation* ("Bemba 4th Decision on Victim Participation"), ICC-01/05-01/08-320, 12 December 2008, para. 31; *Prosecutor v. Gbagbo*, Pre-Trial Chamber I, *Decision on Victim's Participation and Victims' Common Legal Representation at the Confirmation of Charges Hearing and in the Related Proceedings*, ICC-02/11-01/11-138, 4 June 2012, para. 21.

¹⁸ *Shih*, Ligji nr. 2004/32 për të drejtën e familjes, që parashikon në nenin 15(2)-(3) se aftësia juridike fitohet në moshën 18 vjeç.

¹⁹ Formulari i Kërkesës, Pjesa 4.

paraqiten dokumentet në vijim: certifikatat e lindjes, letërnjoftimet që përmbajnë të dhënat e prindit ose kujdestarit ligjor, vendimet gjyqësore mbi kujdestarinë, dokumentacion tjetër të lëshuar nga autoritetet lokale ose shtetërore.²⁰

(c) Krimi (krimet) e pretenduara

31. Sipas nenit 22(1) të Ligjit dhe rregullës 113(4) të Rregullores, parashtuesi i kërkesës duhet të deklarojë se ka qenë viktimë e një ose më shumë krimeve në aktakuzë. Në këtë kontekst, “krim” i referohet cilitdo prej krimeve të pasqyruara në Aktakuzën e Konfirmuar. Parashtuesi i kërkesës duhet të përshkruajë, në sa më shumë hollësi që është e mundshme, vendin dhe kohën e ngjarjes dhe, nëse është e mundshme, çdo kryes të veprave të pretenduara, të pranishëm në vendngjarje ose të përfshirë në ngjarje.

(d) Dëmi i pësuar personalisht

32. Sipas nenit 22(1) të Ligjit dhe rregullave 2 dhe 113(4) të Rregullores, parashtuesi i kërkesës duhet të ketë pësuar dëm, përfshirë dëm fizik, mendor ose material, si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të përfshira në aktakuzë.

33. Lidhur me dëmin që duhet të jetë pësuar *personalisht* nga viktima, kjo nënkupton kushtin që dëmi të jetë pësuar nga parashtuesi i kërkesës, me fjalë të tjera janë shkaktuar pasoja mbi mirëqenien e vet fizike ose psikologjike ose gjendjen ekonomike. Këtu mund të përfshihen dëmet e pësuar nga viktimat që kanë qenë objekt i veprimeve të kryesve (“viktimat e drejtpërdrejta”)²¹ ose të pësuar nga individët në

²⁰ *Po aty*, STL, *Ayyash et al.* Decision on Victims Participation, para. 33.

²¹ *Po aty*, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, Appeals Chamber, Judgement on Prosecution and Defence Appeals against Trial Chamber 1 Decision on Victim Participation of 18 January 2008 (“Lubanga Appeal Appeals Decision on Victim Participation”), ICC-01/04-01/06-1432, 11 July 2008, para. 32; *Prosecutor v. Lubanga*, Trial Chamber I, *Redacted Version of “Decision on ‘Indirect Victims’”* (Lubanga Decision on Indirect Victims), ICC-01/04-01/06-1813, 8 April 2009, para. 44; CCC, *Co-prosecutors v. Kaing*, Appeals Chamber, *Appeal*

marrëdhënie të afërt me viktimën e drejtpërdrejtë të vrarë ose lënduar nga kryesit ("viktimat e tërthorta").²²

34. Lidhur me dëmin fizik, parashtruesit e kërkesave duhet të japin një përshkrim të lëndimit konkret trupor, duke detajuar, me aq sa munden, llojin, sa i rëndë është lëndimi, pjesën e trupit dhe numrin e lëndimeve, si dhe pasojat e tyre mbi shëndetin e viktimave, aftësinë për të punuar dhe mirëqenien.²³ Si provë të dëmit fizik, parashtruesit e kërkesave mund të paraqesin, për aq sa janë të disponueshme, certifikata mjekësore (të dhënat e spitalit, radiografi ose rezultate të skanimeve të tjera, raporte të mjekëve, etj.), receta për barna, fotografi ose dokumentacion tjetër si dëshmi të lëndimeve trupore.²⁴

35. Sa i përket dëmit mendor, parashtruesit e kërkesave duhet të japin përshkrimin e vuajtjeve psikologjike konkrete, duke dhënë hollësi, për aq sa është e mundshme, për llojin, sa të rënda janë, dhe simptomat, si dhe pasojat në shëndetin e viktimës dhe aftësinë për të punuar dhe mirëqenien.²⁵ Si provë të dëmit mendor, parashtruesit e kërkesave mund të paraqesin, për aq sa janë të disponueshme, dëshmi të lëshuara nga profesionistë të kualifikuar, si mjekë, psikologë, psikiatër ose këshilltarë ose çfarëdo dokumentacioni tjetër që dëshmon për vuajtjet psikologjike.²⁶

Judgment ("Appeals Judgement on Duch case"), 3 February 2012, para. 416; STL, *Ayyash et al*, Decision on Victim Participation, para. 39.

²² Po aty, ICC, Appeal Decision on *Lubanga* case on Victim Participation, para. 1, 32; *Lubanga Decision on Indirect Victims*, para. 44, 50; ECCC, *Duch Appeal Judgement*, para. 417; STL, *Ayyash et al*. Decision on Victim Participation, para. 39; ICC, *Prosecutor v. Abdallah Banda*, Trial Chamber IV, V Decision on 19 Applications to Participate in the Proceedings, ICC-02/05-03/09-528, December 2013, para. 26; STL, *Ayyash et al*. Decision on Victim Participation, para. 67; STL, *Prosecutor v. Ayyash*, Pre-Trial Judge, Decision Relating to Victims' Participation in the Proceedings and Their Legal Representation ("2020 Ayyash Decision on Victim Participation"), 17 April 2020, para. 25.

²³ Formulari i kërkesës, Nën pjesa 2.3.

²⁴ Po aty, STL, *Ayyash et al.*, Decision on Victim Participation, para. 67; 2020 para. 36.

²⁵ Formulari i Kërkesës, Nën pjesa 2.3.

²⁶ Po aty, STL, *Ayyash et al*. Decision on Victim Participation, para. 79; 2020 *Ayyash* Decision on Victim Participation, para. 43.

36. Sa i përket dëmit material, parashtruesit e kërkesave duhet të japin përshkrimin e objektit fizik konkret ose të dëmit ose humbjes financiare, duke dhënë hollësi, për aq sa është e mundshme, të numrit dhe kategorisë/llojit të gjërave të dëmtuara, të shkatërruara ose të humbura, llojin dhe përmasat e dëmit ose humbjes së pësuar, si dhe pasojat në të ardhurat e viktimës.²⁷ Si provë të dëmit material, parashtruesit e kërkesave mund të paraqesin, për aq sa janë të disponueshme, dokumentacionin që dëshmon për pronën personale dhe/ose të ardhura të mëhershme së bashku me dokumentacionin që demonstroi dëmin material të pësuar, siç janë kërkesat për dëmshpërblim nga sigurimet, vlerësimet ose faturat për riparime, fotografitë, vërtetimet e ndihmave për të papunët, dhe dokumente të tjera përkatëse.²⁸

(e) Rezultati i drejtpërdrejtë i një krimi që përmban Aktakuza

37. Sipas nenit 22(1) të Ligjit dhe rregullave 2 dhe 113(4) të Rregullores, dëmi i pësuar duhet të jetë rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të pretenduar në Aktakuzë.

38. Dëmi është rezultat i drejtpërdrejtë i krimit kur, në rrethanat që kanë ekzistuar në vendin dhe kohën përkatëse dhe duke marrë parasysh gjendjen personale të viktimës, kishte shumë të ngjarë që veprimet ose mosveprimet e kryesve ta shkaktonin atë dëm, nga këndvështrimi i një vëzhguesi objektiv.²⁹ Parashtruesit e kërkesave duhet të tregojnë lidhjen shkakore midis dëmit dhe krimit të paraqitur në Aktakuzën e Konfirmuar duke dhënë përshkrimin e ngjarjeve, me hollësi, për aq sa është e mundshme, të veprimeve dhe mosveprimeve që kanë shkakuar dëmin, vendin, kohën, zhvillimin dhe kohëzgjatjen e ngjarjeve, si dhe të gjitha rrethanat e tjera me rëndësi.³⁰

²⁷ Formulari i Kërkesës, Nën pjesa 2.3.

²⁸ *Po aty*, STL, *Ayyash et al.* Decision on Victim Participation, para. 74-75; 2020 *Ayyash* Decision on Victim Participation, para. 38-40.

²⁹ *Po aty*, ndonëse në kontekstin e Statutit të Romës: ICC, *Bemba* 4th Decision on Victim Participation, para. 77.

³⁰ Formulari i Kërkesës, Nën pjesa 2.2.

(f) Rekomandimi i ZPV-së

39. ZPV-ja i dorëzon të gjitha kërkesat, pavarësisht nëse për mendimin e saj, janë të pranueshme (Grupi A) ose jo (Grupi B) ose nëse duhet t'i lihet Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të vendosur (Grupi C). Sidoqoftë, para paraqitjes së kërkesave, ZPV-ja mund t'i informojë parashtruesit e kërkesave për kriteret e nenit 22(1) të Ligjit dhe mund t'u japë parashtruesve të kërkesave mundësinë që të plotësojnë ose tërheqin këto kërkesa nëse dëshirojnë.

40. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake udhëzon ZPV-në të paraqesë rekomandime për pranueshmëri, duke marrë parasysh kriteret e lartpërmendura.

2. Grupimi i parashtruesve të kërkuësve

41. Në përputhje me nenin 22(4) të Ligjit dhe rregullën 113(2) dhe (8) të Rregullores, ZPV-ja jep rekomandim për përfaqësimin e përbashkët. Ajo mund të propozojë që parashtruesit e kërkesave të cilët janë rekomanduar të pranohen (Grupi A) ose në lidhje me cilët ZPV-ja ia ka lënë vendimin Gjykatësit të Procedurës Paraprake (Grupi C), të formojnë një grup, të përfaqësuar nga një mbrojtës i përbashkët i viktimave, ose disa grupe, secili me përfaqësim të përbashkët. Për këtë qëllim, ajo mban parasysh kriteret e përcaktuara në rregullën 113(8) të Rregullores.

42. Nevoja për t'i ndarë parashtruesit e kërkesave në më shumë grupe del kur situata apo veçoritë e viktimave janë kaq të ndryshme sa që interesat e tyre janë të papajtueshme,³¹ duke e bërë kështu përfaqësimin e tyre të përbashkët të parealizueshëm. Megjithatë, vetëm pangjashmëria midis rrethanave personale të

³¹ *Po aty, ICC, Prosecutor v. Abdallah Banda and Jerbo, Trial Chamber IV, Decision on Common Legal Representation ("Banda and Jerbo Decision"), ICC-02/05-03/09-337, 25 May 2012, para. 42.*

viktimave mund të mos jetë e mjaftueshme për të krijuar më shumë se një grup. Si rrjedhojë, fakti që viktimat kanë pësuar dëm në forma të ndryshme, kanë qenë objekt i krimeve të ndryshme, kanë përkatësi etnike të ndryshme, banojnë në rajone të ndryshme, kanë origjinë nga shtete të ndryshme, flasin gjuhë të ndryshme, kanë pikëpamje politike të ndryshme ose kanë një interes ose pikëpamje më shumë, me të cilat viktimat e tjera nuk pajtohen por as nuk i kundërshtojnë, mund të mos përliqë automatikisht përfaqësim të ndarë.³² Anasjelltas, kur disa prej faktorëve të lartpërmendur kanë pika takimi, konkretisht, kur viktimat kanë pësuar dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të ndryshme, të cilët kanë ndodhur në rrethana të ndryshme, në data të ndryshme dhe në vende të ndryshme, duke përdorur *modi operandi* të ndryshme dhe pasur si cak individë të ndryshëm, ndarja e viktimave në më shumë se një grup mund të jetë e domosdoshme.³³ E njëjta gjë vlen kur një faktor themelor i bën interesat e tyre të papajtueshme, si në rastin kur disa nga viktimat u kanë shkaktuar dëme viktimave të tjera.³⁴

43. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e udhëzon ZPV-në që t'i paraqesë rekomandimet mbi grupimet për përfaqësim të përbashkët duke marrë parasysh kriteret e lartpërmendura.

³² *Po aty*, ICC, *Banda and Jerbo* Decision, para. 42; STL, *Ayyash et al.* Decision on Victim Participation, para. 124. *Shih, gjithashtu*, ICC, *Prosecutor v. Kosgey and Sang*, Registry, Summary of Information Relevant to the Grouping of Victims, ICC-01/09-01/11-243-Anx2, 1 August 2011, para. 2-3, 7-11; *Prosecutor v. Muthaura et al.*, Registry, Summary of Information Relevant to the Grouping of Victims, ICC-01/09-02/11-214-Anx2, 5 August 2011, para. 2-3, 8-12; *Prosecutor v. Abdallah Banda and Jerbo*, Registry, Summary of Information Relevant to the Grouping of Victims, ICC-02/05-03/09-203-Anx2-Red, 25 August 2011, para. 5.

³³ STL, 2020 *Ayyash* Decision on Victim Participation, para. 66.

³⁴ ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, Trial Chamber II, Order on the Organisation of Common Legal Representation of Victims, ICC-01/04-01/07-1328, 22 July 2009, para. 12(c); *Prosecutor v. Ntaganda*, Pre-Trial Chamber I, Decision Concerning the Organisation of Common Legal Representation of Victims, ICC-01/04-02/06-160, 2 December 2013, para. 10, 23.

3. Masat mbrojtëse

44. Në përputhje me rregullat 80 dhe 113(2) dhe (5) të Rregullores, ZPV-ja jep rekomandime lidhur me kërkesat e parashtruesve për masa mbrojtëse nëse janë të domosdoshme për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre. Këto rekomandime vlejnë për të gjithë parashtruesit e kërkesave, konkretisht: (i) për parashtruesit e kërkesave që janë rekomanduar për t'u pranuar (Grupi A) dhe për ata për të cilët ZPS-ja ia ka lënë vendimin Gjykatësit të Procedurës Paraprake (Grupi C); dhe (ii) për arsye të konfidencialitetit të procesit të parashtrimit të kërkesave, për të gjithë parashtruesit e kërkesave që janë refuzuar (Grupi B).

45. Sipas rregullës 80(4)(a), (d) dhe (e) të Rregullores, masat përkatëse në këtë fazë të procesit janë si në vijim: fshirja e emrave dhe të dhënave identifikuese të personave nga dokumentacioni publik i DHS-së (rregulla 80(4)(a)(i)); mosnxjerrja e dokumentacionit që identifikon parashtruesin e kërkesës (rregulla 80(4)(a)(ii)); caktimi i një pseudonimi (rregulla 80(4)(a)(vi)); mosnxjerrja nga mbrojtësi i specializuar për të akuzuarin të materialit apo informacionit që mund të çojë në nxjerrjen e identitetit të parashtruesit të kërkesës (rregulla 80(4)(d)); ose, në rrethana të jashtëzakonshme, dhe në varësi të garancive mbrojtëse të nevojshme, mosnxjerrja për palët e asnjë materiali të përmendur më lart (rregulla 80(4)(e)).

46. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton standardin ligjor për të përcaktuar nëse një informacion i caktuar mund të mos i jepet palës marrëse,³⁵ me anë të të cilit vlerësohet nëse::

- (i) nxjerrja e informacionit në fjalë përbën rrezik objektivisht të arsyetueshëm për personin ose interesin e mbrojtur;

³⁵ KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje Përkatëse*, 9 tetor 2020, publik, para. 76.

- (ii) masa mbrojtëse është rreptësisht e domosdoshme.³⁶ Si rrjedhojë, nëse janë të mjaftueshme dhe të realizueshme masa mbrojtëse më pak kufizuese, duhet të zgjidhen masa mbrojtëse të tilla; dhe
- (iii) masa mbrojtëse është proporcionale kundrejt cenimit që i shkaktohet të akuzuarit dhe gjykimit të drejtë.³⁷

47. Në rastin kur parashtruesi i kërkesës nuk ka kërkuar masa mbrojtëse sipas rregullës 80, ZPV-ja udhëzohet që të bëjë rekomandime nëse duhen masa mbrojtëse dhe cilat masa mbrojtëse duhet të miratojë Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vendimin e tij, duke pasur parasysh fazën e procesit dhe faktorë të tjerë përkatës.

48. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e udhëzon ZPV-në që të paraqesë rekomandime për masa mbrojtëse që përmenden në paragrafin 45, duke mbajtur parasysh standardin ligjor të lartpërmendur.

F. ROLI I PALËVE NË PROCESIN E PARASHTRIMIT TË KËRKESAVE

49. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, sipas rregullës 113(1) të Rregullores, Formularët e Kërkesave nuk u bëhen të njohura palëve. Sidoqoftë, në bazë të rregullës 113(2) të Rregullores ZPV-ja është e obliguar, që t'u dorëzojë palëve një përmbledhje konfidenciale të Raportit për GjPP-në ("Raport për Palët"). Ky raport dorëzohet njëkohësisht me Raportin për GjPP-në; ndryshe, ZPV-ja mund të tregojë nëse Raporti për GjPP-në mund të riklasifikohet që të mund t'u tregohet palëve, me kusht që të mos përmbajë informacion identifikues që duhet të redaktohet. Raporti për Palët duhet të përfshijë informacionin në vijim, duke mos dhënë informacion identifikues për parashtruesit e kërkesave:

- (a) një përmbledhje të procesit të mbledhjes së kërkesave;

³⁶ Neni 21(6)i Ligjit.

³⁷ Rregulla 80(1) e Rregullores.

- (b) numrin e gjithsejtë të kërkesave të marra dhe numrin e kërkesave të dorëzuara Gjykatësit të Procedurës Paraprake;
- (c) krimet ose vendet e krimeve të pretenduar dhe kryesin ose kryesit e pretenduar;
- (d) numrin e viktimave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, kërkesat e të cilave janë paraqitur, dhe llojin e dokumentacionit të paraqitur për të vërtetuar identitetin, lidhjen familjare, kujdestarinë ligjore;
- (e) llojet e dëmeve të pretenduara dhe llojin e dokumentacionit të pranuar për të provuar dëme të tilla;
- (f) një përmbledhje të rekomandimit të ZPV-së mbi pranueshmërinë, e cila përmban numrin e kërkesave që propozohet të pranohen (Grupi A), të refuzohen (Grupi B) ose t'i lihen Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të vendosur (Grupi C), me një përshkrim të përgjithshëm të arsyeve për secilin grup;
- (g) një përmbledhje të rekomandimeve të ZPV-së lidhur me grupimin, me qëllim përfaqësimin e përbashkët, me një përshkrim të përgjithshëm të arsyeve për këtë; dhe
- (h) një përmbledhje të masave mbrojtëse të kërkuara dhe të rekomandimeve të ZPV-së për to.

50. Në bazë të Raportit për Palët dhe në përputhje me rregullën 113(3) të Rregullores, palët mund të bëjnë parashtrime në lidhje me aspektet ligjore mbi pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, konkretisht në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kriterëve të trajtuara në paragrafët 27-43.

51. Duke mbajtur parasysh se mosnxjerrja e informacionit për palët duhet të jetë në pajtim me të drejtat e të akuzuarit dhe drejtësinë e procesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se rregulla 113(3) e Rregullores nuk i ndalon palët që të bëjnë

parashtrime në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kriterëve të trajtuara në paragrafët 44-47 në lidhje me çdo kërkesë për masa mbrojtëse sipas rregullës 80(4)(d) ose (e) të Rregullores.

52. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron palët të paraqesin parashtrimet e tyre mbi pranueshmërinë, përfaqësimin e përbashkët dhe masat mbrojtëse brenda dhjetë (10) ditësh nga Raporti për Palët.

53. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton më tej se, sipas rregullës 113(6) të Rregullores, palët mund të kërkojnë leje për të apeluar vendimin për pjesëmarrjen e viktimave, por vetëm mbi bazën e gabimeve ligjore.

G. MJETET LIGJORE PËR KËRKESAT E REFUZUARA

54. Sipas rregullës 113(6) të Rregullores, parashtruesit e kërkesave kanë të drejtë të apelojnë vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake që refuzon kërkesat e tyre. Apele të tilla duhet t'i paraqiten Panelit të Gjykatës së Apelit brenda 14 ditësh nga vendimi për refuzimin e kërkesës. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, në përputhje me rregullat 9(2) dhe 113(5) të Rregullores, afati i lartpërmendur fillon nga dita e parë e punës pas njoftimit të parashtruesit të kërkesës mbi vendimin që refuzon pranimi.

IV. VENDIM

55. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **UDHËZON** Administratoren që t'i lejojë qasje ZPV-së në versionet e paredaktuara të Aktakuzës së Konfirmuar dhe Vendimit të Konfirmimit;
- b. **URDHËRON** ZPV-në që të mos i japë asnjë personi informacion pa redaktimet që përmbajnë versionet publike të Aktakuzës së Konfirmuar dhe Vendimit të Konfirmimit;

- c. **URDHËRON** ZPV-në që ta dorëzojë raportin për GjPP-në sipas udhëzimeve dhe orientimeve të përcaktuara në këtë vendim, deri më 10 dhjetor 2020;
- d. **URDHËRON** ZPV-në që të dorëzojë Raportin për Palët në të njëjtën kohë me Raportin për GjPP-në ose ta bëjë të ditur nëse Raporti për GjPP-në mund të riklasifikohet që të mund t'u bëhet i ditur palëve;
- e. **URDHËRON** ZPV-në që të paraqesë rregullisht Raporte të tjera për GjPP-në, nëse do të ketë, dhe më së voni deri në dorëzimin e parashtrimit të Mbrojtjes në përputhje me rregullën 95(5) të Rregullores;
- f. **URDHËRON** ZPV-në që t'i dorëzojë Raportet e tjera për Palët, njëkohësisht me Raportet e tjera për GjPP-në, siç përcaktohet në paragrafin 55.b; dhe
- g. **URDHËRON** Prokurorin e Specializuar dhe Mbrojtjen e z. Mustafa që të dorëzojnë parashtrime në përputhje me rregullën 113(3) të Rregullores, nëse kanë, brenda dhjetë (10) ditësh nga njoftimi i çdo Raporti për Palët ose, sipas rastit, versionet e riklasifikuara të çdo Raporti për GjPP-në.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E premte, 27 nëntor 2020
Në Hagë, Holandë.